



SHOQËRIA "XM" shpk
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

V E N D I M

Nr. 3, Datë 05/03/2020

Sot, më datë 05/03/2020, në selinë e shoqërisë u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "XM" shpk, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82224013T, me zyrë qendore të shoqërisë në adresën: Tirane, Vaqarr, Njësia Administrative Nr. 7, Pasuria me Nr. 4/14, Volumi 4, Faqe 166, Zona Kadastrale Nr. 3712. Në mbledhjen e Asamblesë janë të pranishëm dy ortakët e Shoqërisë, që përfaqësojnë 65 % të kapitalit të Shoqërisë:

1. **Shoqëria "Creo" sh.a** shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82223022N, dhe seli në adresën: Tiranë, Njesia Administrative Nr. 7, Rruga "Dritan Hoxha", Godina midis Tirana Ring Center dhe Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Kati 5, Ap. 46, **përfaqësuar nga Administratori Z. Diego Puntillo**, shtetas italian, i biri i Francesco, lindur më 18.12.1962, në Maderata Itali, banues në adresën: 1A301, Century BinJiang, Shilong Town, DongGuan City, GuangDong Province, Kinë, identifikuar me Pasaportën me nr. YA9173618, zotëruese e 55% të kapitalit të Shoqërisë;
2. **Znj. Milvia Simonetti**, shtetase italiane, lindur më 01.09.1962 në Potenza Picena (MC) dhe banuese në Itali në adresën: Via "Aprutina", Nr. 134, Potenza Picena (MC), identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. AT 6452070, zotëruese e 10 % të kapitalit të Shoqërisë.

Mbledhja e sotme ka rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Miratimi i anulimit të kuotës së ortakut Fu Li, zotërues i 1 kuote, që përfaqëson 35 (tridhjetë e pesë) % të kapitalit në shoqërinë "XM" shpk;
2. Të tjera.

Mbledhja u hap në orën 10:00, dhe u diskutuan pikat e rendit të ditës. U verifikua se z. Diego Puntillo, në cilësinë e përfaqësuesit të ortakut "CREO" sha është i autorizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve për përfaqësimin e shoqërisë në këtë mbledhje. Rezulton që ortaku z. Fu Li nuk është prezent në mbledhje. U verifikua nga ana e ortakeve prezent si dhe nga Departamenti i Financës së shoqërisë se nga ana e ortakut Fu Li nuk është derdhur asnjë pagesë lidhur me kontributin e pashlyer në kapitalin e shoqërisë. Sipas Vendimit të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve date 12.02.2020, depozituar pranë QKB, është parashikuar një afat 7 (shtatë) Ditor brenda të cilit Ortaku Fu Li kishte detyrimin të shlyente kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë. Rezulton se kontributi nuk është shlyer brenda këtij afati. Nga ana e ortakut nuk ka patur asnjë komunikim apo korrespondencë me ortakët e tjerë apo administratorin e shoqërisë lidhur me mënyrën e shlyerjes së kontributit, arsyet e moshlyerjes së tij Brenda afatit të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve, si dhe nuk është paraqitur asnjë

Administratëria Beshtje

kërkesë me shkrim në adresën postare të shoqërisë apo adresat elektronike të ortakëve, nuk është bërë asnjë kërkesë qoftë verbale për shtyrjen e afatit të pagesës së kontributit.

Në përfundim të mbledhjes, në mbështetje të neneve 81 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutit të Shoqërisë "XM" sh.p.k, duke marrë në konsideratë nevojën e shoqërisë për likuiditet me qëllim zhvillimin normal të veprimtarisë së saj tregtare, si dhe me qëllim garantimin e vijimësisë ekonomike të shoqërisë,

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e anulimit të kuotës së ortakut Fu Li, zoterues i 1 kuotë, që përfaqëson 35 (tridhjetë e pesë) % të kapitalit në shoqërinë "XM" shpk.
2. Anullimin e kuotës së ortakut Fu Li, i cili kryhet për shkak të mosshlyerjes prej tij të kontributit në kapitalin e shoqërisë, duke e vendosur Shoqërinë në vështirësi serioze financiare për zhvillimin e aktivitetit të saj tregtar.
3. Anullimin e kuotës së Ortakut Fu Li për shkak të mosshlyerjes së kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë, konkretisht në vlerën 19 253 500,00 Lekë, i cili behet në përputhje me nenin 10/1 pika 3 të Statutit të Shoqërisë "XM" Shpk.
4. Pas anulimit të kuotës së ortakut Fu Li, kapitali i shoqërisë në vlerë parash si dhe përqindjet përkatëse të ortakëve në kapital do të jenë sipas tabelës më poshtë:

	Në vlerë parash		Në përqindje në kapital	
	Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet
Kapitali total	55 010 000,00	35 756 500,00		
Kapitali Creo sh.a	30 255 500,00	30 255 500,00	55 %	85%
Kapitali FU LI	19 253 500,00	-	35%	0%
Kapitali Milvia Simonetti	5 501 000,00	5 501 000,00	10%	15%

5. Autorizimin e Administratorit të Shoqërisë apo çdo personi të autorizuar prej tij për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKET E SHOQERISE "XM" Shpk

Milvia Simonetti

MILVIA SIMONETTI



Shoqëria "CREO" Sha
Administrator: Diego Ponzillo

DIEGO PONZILLO



Diego Ponzillo